

Buletini Numër 4.

STATISTIKAT VITALE TË KOSOVËS
PËR VITIN 2004

PRISHTINË, 2005

Kapitulli I: Sistemi i Statistikave Demografike në Kosovë

1.1 Historiku i shkurtër

Të dhënat për lindje, vdekje dhe kurorëzime gjatë viteve 1900-1912 janë siguruar përmes teftereve turke, të cilat i kanë udhëhequr në zyra të veçanta administrative dhe në institucionet fetare.

Edhe në periudhën e viteve 1921-1939, të dhënat për statistikat e jetës janë siguruar kryesisht përmes evidencave në institucionet fetare (kisha dhe xhamia), një pjesë e vogël është siguruar përmes ofiqarive shtetërore, ndërsa shkurorëzimet përmes gjykatave kompetente për shkurorëzime.

Pas luftës së dytë botërore, funksionimi i Sistemit të Statistikave Demografike në Kosovë fillon në vitin 1947, dhe të gjitha të dhënat për statistikat demografike (lindjet, vdekjet dhe kurorëzimet) janë siguruar përmes Zyrave të Ofiqarive, ndërsa për shkurorëzime nga Gjykatat kompetente për shkurorëzime.

Rrënimi i SSD nisë me fillimin e çregullimeve politike në Kosovë në vitin 1989, ndërsa shkatërrimi total gjatë luftës më 1999, gjë që pason me çregullimin dhe rrënimin e shumë zyrave të ofiqarive si dhe asgjësimin dhe vjedhjen-tërhjekjen e shumë librave amzë (në disa Zyra të Ofiqarive edhe librat amzë prej vitit 1900) në Serbi.

Përpjekjet e para për fillimin e funksionimit të këtij institucioni bëhen në fund të vitit 1999, kur UNMIK-u formon regjistrin e ri civil të cilin e jetësoi, duke botuar çertifikata të reja dhe libra amzë.

Pas rifillimit të procesit të regjistrimit civil, sigurimi i të dhënave për statistikat demografike është emërtuar si prioritet i respektuar, është titulluar “Riaktivizimi i Sistemit të Statistikave Demografike”, dhe është planifikuar me Departamentin e Statistikave të Popullsisë të ESK.

Në fillim ndihma e përgjithshme teknike është siguruar nga Universiteti i Montrealit në Kanada, dhe më pastaj edhe nga qeveria Holandeze, me UNFPA / si agjension ekzekutiv.

Në gusht të vitit 2001, fillon riaktivizimi i Sistemit të Statistikave Demografike, me grumbullimin e të dhënave për lindje, kurorëzime dhe vdekje.

Në janar të vitit 2004, Departamenti i Statistikave të Popullsisë riaktivizon edhe pjesën tjetër të Sistemit të Statistikave Demografike- shkurorëzimet, dhe rezultatet e para pas lufte publikohen në këtë buletin.

1.2 Burimet e të dhënave, mbledhja dhe procesimi

Burimi i vetëm dhe kryesor i informatave për statistikat demografike, është evidenca në Librat Amzë për lindje, vdekje dhe kurorëzime, të cilat mbahen në Zyrat e Gjendjes Civile (Zyrat e Ofiqarive).

Për lindjet dhe vdekjet që ndodhin në institucionet medicinale, personeli mjekësor, i plotëson formularët statistikor, për lindje DEM-1 dhe për vdekje DEM-2.

Një kopje të formularit të plotësuar, institucioni medicinal-mjekësor e ndalë për nevoja të veta administrative, një kopje i dorëzohet personit për të cilin është e lidhur ngjarja, ndërsa dy kopje të formularit (njëra e dedikuar për ESK) dërgohen në Zyrat e Gjendjes Civile.

Zyrat e gjendjes civile pasi i regjistrojnë ngjarjet në librat amzë, një kopje të formularit statistikor e dërgojnë në ESK.

Sipas rregullativës ligjore, por edhe me rekomandime metodologjike është precizuar, që ngjarjet vitale duhen të regjistrohen aty ku edhe ndodhin .

Gjatë përpunimit, dhe me rastin e publikimit, të dhënat grupohen sipas vendbanimit të përhershëm/ zakonshëm, për rastet e lindjeve sipas vendbanimit të përhershëm të nënës së fëmijës së lindur, për rastet e vdekjeve sipas vendbanimit të përhershëm të personit të vdekur dhe për kurorëzime sipas vendbanimit të përhershëm të të kurorëzuarve.

Sa i përket kalkulimit të nivelit të ngjarjeve dhe informatës për statistikat demografike, të dhënat publikohen sipas veçorive kryesore si: mosha, gjinia, përkatësia kombëtare, komunat/ vendbanimet, përgatitja shkollore, fertiliteti, etj. që zakonisht kërkohen edhe me regjistrimin e popullsisë.

Është shumë me rëndësi të kuptohet dhe të zbatohet rregullativa ligjore e cila i obligon qytetarët e Kosovës që të regjistrojnë me kohë ngjarjet vitale, në librat amzë, në Zyrat e Gjendjes Civile.

1.3 Rëndësia

Për ta analizuar situatën demografike të një vendi, burimet kryesore sigurohen nga të dhënat e fituara me Regjistrimin e Popullsisë (i cili sipas rregullave të Kombeve të Bashkuara realizohet në çdo dhjetë vjet), dhe Sistemit të Statistikave Vitale.

Këtyre informatave i pason edhe pjesa tjetër e të dhënave të popullatës dhe variablat kryesore demografike siç janë nataliteti, mortaliteti, dhe migracionet. Këta janë tre faktorë përmes të cilëve maten ndryshimet në popullsinë e një vendi.

Nga kjo rrjedhë se: popullsia e një vendit rritet apo zvogëlohet me shtimin natyror pozitiv apo negativ të popullsisë dhe në bazë të saldos pozitive apo negative të migracioneve (d.m.th.

popullsia e një vendit rritet kur një fëmijë lindë ose kur ndokush nga jashtë vjen të jetojë në këtë vend, kurse popullsia e një vendit zvogëlohet kur ndokush vdes ose ndokush largohet për të jetuar në ndonjë vend tjetër).

Kjo mund të prezantohet edhe me këtë formulë:

$$P_1 = P_0 + (L - V) + (I - E)$$

P₁ - vlerësimi i popullsisë në mes të vitit

P₀- numri mesatar i popullsisë në mes të vitit

L- numri i lindjeve të gjalla brenda vitit kalendarik,

V- numri i vdekjeve brenda vitit kalendarik,

I- numri i imigrimeve, dhe

E- numri i emigrimeve brenda vitit kalendarik.

Në bazë të këtyre parametrave, numri i popullsisë së një vendi mund të llogaritet, vlerësohet dhe prognozohet saktësisht, nëse numri i lindjeve, numri i vdekjeve dhe saldo e migrimit, janë të sakta.

Sidoqoftë, sistemi i tanishëm i regjistrimit të ngjarjeve demografike, mbledh informata vetëm për lindjet, vdekjet, kurorëzimet dhe shkurorëzimet.

Tani në mungesë të funksionimit të shërbimit për përcjelljen e lëvizjeve të popullsisë-migrimeve (të brendshme dhe të jashtme) nuk është i mundur sigurimi dhe prodhimi i informatave për migrime.

Që të mund të arrihet zënia e ngjarjeve, në shkallën e nivelit dhe cilësisë së duhur, DSP ka organizuar trajnime, seminare/takime dhe diskutime në nivel qendror, rajonal, dhe komunal.

DSP, është i vetëdijshëm, se kjo nuk mund të arrihet pa ndihmën dhe përkrahjen e të gjithë shfrytëzuesve dhe pjesëmarrësve kryesorë që janë në procesin e mbledhjes së shënimeve, e sidomos të institucioneve të cilat ndërtojnë infrastrukturën ligjore dhe obligojnë zbatimin e saj.

Gjithashtu, është e nevojshme që të sigurohet hapësira për pjesëmarrjen e plotë të shoqërisë civile, për ngritjen e kulturës, në paraqitjen e ngjarjeve demografike, si komponentë me rëndësi të veçantë e një shoqërie bashkëkohore.

Tani, Sistemi i Statistikave Demografike në Kosovë është duke funksionuar që nga gushti i vitit 2001, dhe në bazë të rezultateve preliminare, por edhe këtyre përfundimtare, krahasuar me periudhat e mëhershme 1948-1990, është konstatuar se edhe përkundër angazhimit të DSP, nuk ishte e mundur zënia e lindjeve më shumë se rreth 85% dhe vdekjeve më shumë se rreth 65%, që nënkupton se nuk janë përmbushë kriteret e KB për mbulimin e ngjarjeve, që të jenë të krahasueshme me ato ndërkombëtare.

Kjo gjendje na sinjalizon se duhet të ndërmerret në përmirësimin, gjegjësisht në ndryshimin dhe plotësimin e infrastrukturës ligjore e cila rregullon sistemin e shërbimit të gjendjes civile në Kosovë, sidomos pjesa e cila ka të bëjë me regjistrimin e lindjeve dhe vdekjeve.

1.4 Aktivitetet e përfunduara

Deri në riaktivizimin e Sistemit të Statistikave Demografike, në muajin korrik të vitit 2001, janë zhvilluar shumë aktivitete, në faza të caktuara.

1.5 Aktivitetet që priten të realizohen

- Për të rumbullakësuar sistemin e statistikave vitale, DSP do të angazhohet:
- Për sigurimin e burimit të dhënave edhe për *migracione*, si komponent e domosdoshme për llogaritjen (vlerësimin) e saktë të numrit të popullsisë.
- Do të inicioj aktivitete të tjera të nevojshme teknike, organizative, profesionale dhe sistimore për *ngritjen e shkallës së zënies së ngjarjeve vitale* (lindjeve dhe vdekjeve) me kohë, si dhe ngritjen e shkallës së cilësisë së informatave të prodhuara dhe shpërndarjen e tyre shfrytëzuesve.
- Ne veçanti duhet të bëhen përpjekje, me qëllim që të ngritët numri i formularëve të regjistruar për statistikën demografike, që vijnë nga vendbanimet me popullatë serbe.
- Do të kushtohet kujdes i veçantë regjistrimit të ngjarjeve/lindjeve dhe vdekjeve në botën e jashtme.

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Lëvizjet e popullsisë

Duke i analizuar të dhënat për lëvizjet natyrore të popullsisë, në periudhën 1948-1997 (gjendja në mes të vitit), kuptojmë se mesatarja e shtimit natyror të popullsisë në Kosovë, sillet rreth 33 673 veta, me normë mesatare vjetore 24.7 promil, gjegjësisht me një shkallë vjetore të rritjes 2.2%.

Në periudhën 1991 deri 1997, mesatarja e shtimit natyror të popullsisë ishte rreth 37 187 banorë ose me normë mesatare rreth 18.0 promil. Shkalla vjetore e rritjes së popullsisë së Kosovës për periudhën e cekur ka qenë 1.775%.

Lëvizjet e popullsisë - vlerësim

Viti	Numri i banorëve ne 000
1991	1 967
1992	2 006
1993	2 043
1994	2 077
1995	2 113
1996	2 151
1997	2 186

Burimi: Vjetari statistikor i Serbisë, 1998 faqe 42. Tab.3-2

Vlerësim

Në mungesë të të dhënave për numrin e popullsisë në Kosovë, që nga regjistrimi i fundit i vitit 1981, me qëllim të krijimit të elementeve bazë për llogaritjen e disa treguesve analitik për statistikat demografike, na imponohet nevoja që t'i përdorim edhe të dhënat nga vjetari statistikor i Serbisë, në mënyrë që në bazë të metodave statistikore për vlerësime, prognoza dhe projeksione, të bëjmë vlerësimin për numrin e popullsisë në Kosovë për periudhën 1998-2004. Të dhënat për numrin e përgjithshëm të popullsisë për periudhën në fjalë, janë vlerësuar dhe janë kalkuluar me shkallën vjetore të rritjes prej 1.775%.

Lëvizjet e popullsisë

Viti	Numri i banorëve ne 000
1998	2 225
1999	2 264
2000	2 304
2001	2 345
2002	2 387
2003	2 429
2004	2 473
2005	2 502

Vlerësim: Divizioni i Statistikave Demografike i ESK

1.7 LËVIZJET E POPULLSISË 1948-1997¹

Vitet	Popullsia me 30.06 në(000)	Lindjet	Vdekjet	Foshnjat vdekura	Shtimi natyror	Në 1000 banorë			Foshnjat e vdekura në 1000 lindje të gjalla
		Gjithsej	Gjithsej			Lindjet	Vdekjet	Shtimi natyror	
1948	733	27 792	10 324	...	17 468	37.9	14.1	23.8	...
1949	751	31 643	12 927	4 208	18 716	42.1	17.2	24.9	133.0
1950	764	35 222	12 991	4 977	22 231	46.1	17.0	29.1	141.3
1951	780	29 299	14 833	5 103	14 466	37.6	19.0	18.5	174.2
1952	793	35 619	13 867	5 197	21 752	44.9	17.5	27.4	145.9
1953	813	34 595	16 726	5 999	17 869	42.6	20.6	22.0	173.4
1954	832	38 595	13 201	5 520	25 394	46.4	15.9	30.5	143.0
1955	842	36 736	15 292	6 025	21 444	43.6	18.2	25.5	164.0
1956	859	37 819	13 692	5 175	24 127	44.0	15.9	28.1	136.8
1957	873	34 159	15 300	5 464	18 859	39.1	17.5	21.6	160.0
1958	890	39 285	11 598	4 928	27 687	44.1	13.0	31.1	125.4
1959	921	37 364	12 878	5 190	24 486	40.6	14.0	26.6	138.9
1960	944	41 631	13 365	5 518	28 266	44.1	14.2	29.9	132.5
1961	972	40 561	11 759	5 108	28 802	41.7	12.1	29.6	125.9
1962	997	41 336	15 024	6 072	26 312	41.5	15.1	26.4	146.9
1963	1 021	41 525	12 423	5 351	29 102	40.7	12.2	28.5	128.9
1964	1 046	42 557	12 731	5 418	29 826	40.7	12.2	28.5	127.3
1965	1 075	43 569	11 767	5 341	31 802	40.5	10.9	29.6	122.6
1966	1 101	42 429	10 266	4 357	32 163	38.5	9.3	29.2	102.7
1967	1 131	44 001	11 308	4 739	32 693	38.9	10.0	28.9	107.7
1968	1 159	44 627	10 781	4 552	33 846	38.5	9.3	29.2	102.0
1969	1 189	46 480	10 892	4 404	35 588	39.1	9.2	29.9	94.8
1970	1 220	44 496	10 829	4 286	33 667	36.5	8.9	27.6	96.3
1971	1 254	47 060	10 312	4 215	36 748	37.5	8.2	29.3	89.6
1972	1 291	47 943	10 270	3 753	37 673	37.1	8.0	29.2	78.3
1973	1 329	47 714	10 358	4 053	37 356	35.9	7.8	28.1	84.9
1974	1 367	49 847	10 075	4 069	39 772	36.5	7.4	29.1	81.6
1975	1 406	49 310	10 018	3 961	39 292	35.1	7.1	27.9	80.3
1976	1 446	51 355	10 149	3 678	41 206	35.5	7.0	28.5	71.6
1977	1 487	49 849	9 811	3 681	40 038	33.5	6.6	26.9	73.8
1978	1 526	49 027	9 776	3 409	39 251	32.1	6.4	25.7	69.5
1979	1 566	48 125	9 575	3 424	38 550	30.7	6.1	24.6	71.1
1980	1 555	53 147	8 909	3 069	44 238	34.2	5.7	28.4	57.7
1981	1 595	48 111	9 677	3 024	38 434	30.2	6.1	24.1	62.9
1982	1 629	52 865	10 479	3 466	42 386	32.5	6.4	26.0	65.6
1983	1 664	49 645	11 040	3 437	38 605	29.8	6.6	23.2	69.2
1984	1 699	55 243	10 573	2 921	44 670	32.5	6.2	26.3	52.9
1985	1 735	53 925	11 826	3 026	42 099	31.1	6.8	24.3	56.1
1986	1 773	54 519	10 446	2 819	44 073	30.7	5.9	24.9	51.7
1987	1 811	56 221	10 307	2 848	45 914	31.0	5.7	25.4	50.7
1988	1 850	56 283	10 257	2 916	46 026	30.4	5.5	24.9	51.8
1989	1 889	53 656	10 181	2 745	43 475	28.4	5.4	23.0	51.2
1990	1 930	55 175	8 214	1 897	46 961	28.6	4.3	24.3	34.4
1991	1 967	52 263	8 526	1 761	43 737	26.6	4.3	22.2	33.7
1992	2 006	44 418	8 004	1 526	36 414	22.1	4.0	18.2	34.4
1993	2 043	44 132	7 804	1 471	36 328	21.6	3.8	17.8	33.3
1994	2 077	43 450	7 667	1 081	35 783	20.9	3.7	17.2	24.9
1995	2 113	44 776	8 671	1 058	36 105	21.2	4.1	17.1	23.6
1996	2 151	46 041	8 392	734	37 649	21.4	3.9	17.5	15.9
1997	2 186	42 920	8 624	781	34 296	19.6	3.9	15.7	18.2

¹ Burimi :-Vjetari Statistikor i Kosovës 1989
-Vjetari Statistikor i Serbisë 1998

Kapitulli II

2.1 Analizat elementare

Gjatë analizimit të fenomeneve demografike për periudhën e viteve 2002,2003 dhe 2004, duhet pasur parasysh faktin se në Kosovë, ngjarjet vitale (lindjet dhe vdekjet), nuk *zihen* (kapen) në shkallë të mjaftueshme, ngase nuk ekziston rregulativa e mirëfilltë ligjore, që do t'i bindë qytetarët për paraqitjen e ngjarjeve në Zyrat e Ofiqarive në afat të caktuar. Andaj, nuk mund të konkludojmë bindshëm se informatat e prodhuara, prezantojnë gjendjen reale për ngjarjet demografike dhe shtimin natyror të popullsisë në Kosovë për periudhat në fjalë.

Siç kemi cekë edhe më herët rritja e popullsisë në mënyrë të drejtpërdrejtë varet nga komponentët natyrore dhe mekanike të lëvizjeve të popullsisë (lindjet e gjalla, vdekjet dhe migrimet). Pra, sa më e lartë të jetë shkalla e zënies së këtyre komponentëve aq më e sakët është informata për shkallën e shtimit të popullsisë së një vendi.

Megjithatë, me angazhimin e personelit profesional të DSP në qendrën e ESK dhe në terren si dhe kontakteve me institucionet relevante, vërehet një përparim i paraqitjes së ngjarjeve demografike, në krahasim më periudhën fillestare të riaktivizimit të Sistemit të Statistikave Demografike më 2001.

Në periudhat e mëhershme (1948-1988), në Kosovë, norma e shtimit natyror e popullsisë ishte më e larta në Evropë, mesatarisht rreth 25 promil.

Në bazë të dhënave të prezantuara në tabelat e këtij buletini, norma e shtimit natyror të popullsisë në Kosovë, në vitin 2004 ishte 11.6 promil. Në krahasim me periudhat e cekura, kjo normë tani, tregon një rënie prej 53.6 %, që është kryesisht rezultat i mos paraqitjes së ngjarjeve vitale.

Edhe në periudhën e viteve 1990-1991, shkalla mesatare e shtimit natyror të popullsisë në Kosovë sillej rreth 23.3 promil, ndërsa, në periudhën 1992-1996, mesatarisht 16,8 promil, me tendencë të rënies se theksuar, më 1997 në 15,7 promil.

Kjo rënie e normës së shtimit natyror të popullsisë, pas vitit 1991, nuk është pasqyrë e gjendjes reale të shtimit të popullsisë në Kosovë, por si rezultat i mos bashkëpunimit (mosregjistrimit të ngjarjeve) të në pjese të popullatës shumicë në Zyrat e Gjendjes Civile.

Për shkaqe sigurie të nënës dhe fëmijës, gjatë viteve 1991, deri pas luftës më 1999 pjesa më e madhe e lindjeve, kryheshin nëpër shtëpi, apo ordianca private, të cilat atë kohë nuk mbanin korrespondencë për ngjarjet vitale me sistemin e regjimit të asaj periudhe. Kjo gjendje për një kohë shkatërroi relacionet në mes të regjistrimit të ngjarjeve vitale dhe popullsisë, dhe është e natyrshme që do të duhet kohë të rehabilitohet gjendja e krijuar. Për vitet 1998, 1999, 2000 dhe 2001, ESK nuk disponon me të dhëna për statistika demografike.


Është brengosëse, se edhe tani, ngjarjet vitale të cilat ndodhin në vendbanimet me shumicë serbe, nuk regjistrohen në Zyrat e Gjendjes Civile të Kosovës. Andaj, DSP i ESK nuk posedon informacione për atë pjesë të popullatës së Kosovës.

2.2.Lindjet:

Në bazë të informatave të fituara përmes sistemit të statistikave vitale, për vitin 2004, kuptojmë se në Kosovë janë regjistruar 35 264 lindje, prej tyre 35 063 të lindur të gjallë, ndërsa 201 të lindur të vdekur. Koeficienti i lindjeve të përgjithshme (numri i lindjeve bruto në 1000 banorë), në vitin 2004 ishte 14.3 promil, ose për 1.0 poena të koeficientit më e lartë se në vitin 2003.


Koeficienti i lindjeve të gjalla (numri i lindjeve të gjalla në 1000 banorë) 14.2 promil ose për 1.0 poena të koeficientit më e lartë se në vitin 2003. Koeficienti i vitalitetit (numri i të lindurve gjallë në 100 persona të vdekur) 5.5, dhe norma e shtimit natyror 11.6 promil.

Raporti i gjinisë të lindjet ishte 1.08, që nënkupton se në 100 femra të lindura gjallë vinin 108 meshkuj. (shih graf.1.1).




Koeficienti i lindjeve të vdekura - vdekjet fetale në 1000 lindje ishte 5.7 promil, ose për 0,3 poena të koeficientit më ulët se në vitin 2003.

Në bazë të raporteve të përpunuara përmes sistemit të statistikave vitale, sigurojmë informata se në vitin 2004, 88,4% e lindjeve kanë ndodhur në institucionet medicinale ndërsa 11,6% në vend tjetër. Prej lindjeve të përgjithshme, 90,4% janë bërë me ndihmën mjekësore, ndërsa 9,6% pa ndihmën mjekësore.




Sipas grup-moshave, numri më i madh i nënave që kanë lindur fëmijë, është i grup-moshave 25-29 vjeç ose 36,0%, pastaj i grup-moshave 20-24 vjeç 27%, grup-moshat 30-34 vjeç, 22,7%, dhe grup-moshat tjera përbëjnë 14,3% të numrit të përgjithshëm të lindjeve të gjalla. (shih graf.1.3).




Mosha mesatare e femrave që kanë lindur fëmijë në vitin 2004, ishte rreth 27.6 vjeç, që është lehtë më e ulët në krahasim me vitin 2003, ku mosha mesatare e femrave që kishin lindur fëmijë ishte 28.1 vjeç

Sipas radhës së lindjes së fëmijës, në vitin 2004, 38.4 % e nënave kanë lindur fëmijën e parë, 28.9% kanë lindur fëmijën e dytë, 18.2% fëmijën e tretë, dhe 14.6% të numrit të përgjithshëm të nënave, përbëjnë ato nëna që kanë lindur 4 e më tepër fëmijë. (shih graf 1.4).




Sipas peshës së fëmijës së lindur, numri më i madh i foshnjave të lindura me 2004, ishte me peshë prej 3000-3499gr. që përbëjnë 31.6% e foshnjave të gjithmbarshme të lindura, pastaj 24.% numri i foshnjave me peshë 3500-3999gr. Foshnjat e lindura me më pak se 3000gr peshë, përbëjnë 17.5 % të numrit të përgjithshëm të të lindurve të gjallë, ndërsa 7.6% janë lindjet me peshë mbi 4000gr.

Për fëmijët e lindur jashtë institucionit mjekësor, sipas metodologjisë së hulumtimit, nuk kërkohen të dhënat për peshën e tyre, dhe ato grupohen në të panjohur, që përbejnë 19.3 % të lindjeve të gjithmbarshme të gjalla. (shih graf.1.5).



Analizuar sipas muajve, numri më i madh i lindjeve ka ndodhur në muajin maj, korrik dhe gusht, rreth 30%, të lindjeve të përgjithshme me 2004. Ndërsa, numri më i vogël i lindjeve ishte në muajt dhjetor 6.3% , nëntor 6.9% dhe shkurt 7.1%, që përbejnë rreth 20% të lindjeve të përgjithshme.



2.3. Vdekjet:

Në bazë të rezultateve të fituara për mes hulumtimit statistikor DEM-2, në vitin 2004, janë regjistruar 6399 raste të vdekjeve (0.28% me pak se në vitin 2003), prej të cilave 3654 apo 57.1% meshkuj, dhe 2745 apo 42.9% femra. (shih graf.2.1).

Raporti i gjinisë të vdekjet ishte 133 meshkuj në 100 femra të vdekura. Prej numrit të përgjithshëm të vdekjeve të regjistruara në 2004, 415 apo 6.5% ishin foshnja.


Ky raport i vdekjeve nuk prezanton gjendjen reale, sepse ka dallime me gjendjen faktike në përmasa të frikshme dhe të dhimbshme.

Ky konkludim është i bazuar në raportet e numrit të vdekjeve të foshnjave me numrin e përgjithshëm të vdekjeve në periudhat jo shumë të largëta, dhe me bindjen reale për gjendjen e rënduar të fletëngarkesës sociale të familjes në Kosovë, sidomos pas lufte.

Më 1971 nga numri i përgjithshëm i vdekjeve, 40.9% ishin foshnje (rreth tetë herë më i lartë se në Vojvodinë, katër herë më i lartë se në Serbi), më 1981 31.2% (rreth 15- pesëmbëdhjetë herë më i lartë se në Vojvodinë, pesë herë më i lartë se në Serbi) dhe më 1989 27,0% (rreth 20- njëzet herë më

i lart se në Vojvodinë, gjashtë herë më i lartë se në Serbi etj). Krahasuar me Kroacinë, apo me Slloveninë, ky raport ishte shumëfish më i theksuar.^{1,2)}

Kjo gjendje konsiston me një histori të keqe që pati Kosova sa i përket këtij segmenti, sidomos pas vitit 1990 dhe kërkon sensibilizimin e situatës, ***për sigurimin e një infrastrukture ligjore në shkallë vendi e cila do i detyronte qytetarët për regjistrimin e ngjarjeve vitale (lindjet dhe vdekjet)***, në Zyrat e Gjendjes Civile. Në të kundërtën, nuk do të kemi informata reale për rastet e lindjeve dhe vdekjeve në Kosovë, mjerisht edhe për një kohë.




Në Kosovë në vitin 2004, 58.5% të rasteve të vdekjeve kanë ndodhur në shtëpi, dhe vetëm 36.9% në spital (institucionet medicionale), dhe 4.6% ne vende të tjera.(Shih graf 2.2).




¹ Burimi: Vjetari Statistikor i Kosovës, 1987 faqe 29 tabela 3.2

² Burimi: Statisticki Godisnjak Srbije, 1998-faqe 42 tabela 3.2


Për rastet e vdekjeve që ndodhin në shtëpi, me vështirësi apo edhe nuk sigurohen fare të dhënat për shkakun e vdekjes dhe veçorit të tjera të domosdoshme që kërkohen me skedën statistikore (DEM-2). Nga informatat e prodhuara, shihet se numri me i madh i rasteve të vdekjeve me 2004, kanë ndodhur te moshë 60 e më shumë vite, që përbejnë 67.4% të të gjitha rasteve të vdekjeve, ndërsa 32.6% përbejnë rastet e vdekjeve nën 60 vite. (shih graf 2.3)



Sipas shkakut të vdekjeve, më 2004 në Kosovë, vdekjet e dhunshme përbëjnë afro 3.7%, të t'gjitha vdekjeve, prej tyre aksidentale 2.7%, vetëvrasjet 0.3% dhe vrasjet 0.7%. (shih graf 2.4)



Sipas muajve, vdekjet më të shumta kanë ndodhur: janari 9.7%, marsi, 9.1%, dhe maj 8.9%, që përbëjnë 27.7% të vdekjeve të përgjithshme me 2004. Muajt me më pak raste të vdekjeve ishin, shtatori me 7.1%, gushti me 7.4%, dhe korriku me 7.5%, që përbejnë 22.0% të vdekjeve të përgjithshme. (shih graf. 2.5).




-Në bazë të lëvizjeve të popullsisë në periudhën 1948-1997, vlerësimeve për periudhën 1998-2004, si dhe supozimit se zënia e ngjarjeve demografike (lindjeve dhe vdekjeve), do të ishte mbi 95% në vitin 2002, 2003 dhe 2004, koeficienti i lindjeve (natalitet) do të ishte rreth 22 promil, koeficienti i vitalitetit 5.5%, norma e shtimit natyror 18.0 promil, koeficienti i vdekshmërisë(mortaliteti) 5.0 promil dhe koeficienti i vdekshmërisë infantile (mortaliteti i foshnjave) rreth 30 promil

2.4 Kurorëzimet

Në Kosovë, në vitin 2004 janë regjistruar 16989 kurorëzime.

Nga të dhënat e fituara përmes këtij hulumtimi, shihet se femrat kurorëzohen në moshë më të re se meshkujtë. Moshja mesatare e të kurorëzuarve në vitin 2004 ishte 28.7 vjet (për femra 27.0 vjet, për meshkuj 30.3 vjet).


Diferenca të moshat mesatare në mes femrave dhe meshkujve të kurorëzuar ishte 3,3 vjet. Sipas grupmoshave, numri më i madh i të kurorëzuarve meshkuj, gjendet në grupmoshat 25-29 vjet, ndërsa tek femrat në grupmoshat 20-24 vjet. Nga numri i përgjithshëm i të kurorëzuarve deri në moshën 29 vjeçare, në vitin 2004, 51,7% ishin meshkuj dhe 72,5% femra.



Në vitin 2004, shumica e kurorëzimeve është bërë në mes të niveleve të njëjta të arsimimit, megjithatë, vërehet se niveli i shkollimit të meshkujve, është diç më i lartë se ai i femrave.


Numri më i madh i meshkujve të kurorëzuar në vitin 2004, ishte me shkollë të mesme 65,3%, ndërsa i femrave të kurorëzuara më të njëjtin nivel të shkollimit ishte 45,6%.

Me shkollë fillore 23,6% e të kurorëzuarve ishin meshkuj, ndërsa 41,8%, femra.




Pjesa më e madhe e kurorëzimeve (92,2%) si te femrat , ashtu edhe te meshkujt (88,5%), bëhet në mes qifteve të pamartuar, ndërsa pjesëmarrja e femrave të ndara në numrin e përgjithshëm të kurorëzimeve më 2004, ishte 4.5%, dhe meshkujve të ndarë 10,6%.

Nga të dhënat e fituara, del se më 2004, 88,5% përbëjnë meshkujt që lidhin martesën për herë të parë, ndërsa femrat 92,2%. Te ndarë,që kanë hyrë në martesë më 2004, meshkujt përbëjnë 10,6% ndërsa femrat 4,5%.




Kurorëzimet sipas muajve në vitin 2004 tregojnë se numri me madh ka ndodhur në muajin mars dhe gusht, ndërsa më së paku në muajin tetor e nëntor.




2.5 Shkurorëzimet

Përmes hulumtimit statistikor- shkurorëzimet SHK-1, kemi siguruar të dhëna se në vitin 2004, në Kosovë janë evidencuar 1293 raste të shkurorëzimeve. Shkalla e shkurorëzimeve në Kosovë në vitin 2004 ishte 7,6. Më shumë shkurorëzime kanë ndodhur në grup-moshat 30-34 vjeç për meshkuj, dhe 25-34 vjeç për femra. Moshë mesatare e femrave të shkurorëzuara në vitin 2004 ishte 31,8 vjeç, kurse e meshkujve 34,7 vjeç (diferenca 2,9 vjet). Dallimi në moshën mesatare të shkurorëzuarve dhe shkurorëzuarve të meshkujt ishte 4,4 vjet, kurse të femrat 4,8 vjet.




Zgjatja e martesës në vitin 2004 ishte mesatarisht 7,7 vite. Me zgjatjen e moshës në martesë, të burrit dhe gruas rritet mesatarja e viteve në martesë. Derisa në grup-moshat nën 20 vjeç mesatarja e zgjatjes së martesës ishte 1,7 vjet, në grup-moshat 45-49 vjeç ishte 16,5 vjet dhe në grup-moshat 60-64 vjeç ajo zgjatet deri në 20,3 vjet. Me rritjen e moshës së gruas dhe burrit, zvogëlohet numri i shkurorëzimeve, sidomos prej moshës 50 vjeçare.

Rastet e shkurorëzimeve janë më të shprehura në mes viteve 20-39 vjet. Femrat hyjnë më herët në martesë, por edhe shkurorëzimi i tyre ndodhë në moshë më të re.



Nga të dhënat e fituara, kuptojmë se dukuria më e shpeshtë e shkurorëzimeve është te meshkujt me arsimim fillor dhe të mesëm të kryer, dukshëm më pak te ata që kanë nivel më të lartë të shkollimit, ndërsa numri më i madh i femrave të shkurorëzuara është i atyre me shkollë të mesme.



Shikuar sipas strukturës së familjes, rastet më të mëdha të shkurorëzimeve kanë ndodhur në mes të qifteve të cilët nuk kishin fëmijë, ndërsa te bashkëshortët të cilët kanë fëmijë, numri i shkurorëzimeve është dukshëm më i vogël.

